

# AKT THEMELIMI

---

## Shoqeria “KURA CORP” sh.p.k

Sot më datë 03/10/2023, une i nënshkruari z. **Muhamedali Kura** shtetas shqiptar, i datelindjes 24/05/1997, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr J70524054L shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**KURA CORP**” sh.p.k si më poshtë vijon:

### 1. FORMA LIGJORE

“**KURA CORP**” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

### 2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku themelues i shoqerise është Muhametali Kura.

### 3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**KURA CORP**” sh.p.k. është :

- Dizenjim software-i
- Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software
- Testim software
- Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit
- Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë
- Zhvillim sistemesh migrimi
- Përmirësim/upgrade sistemesh informatike
- Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.

### 4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “**KURA CORP**” sh.p.k është në adresën: **Rruga "Pjeter Bogdani" ndertesa nr.10, hyrja 5, Ap. 28, Kodi postar 1019.**

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@kuracorp.com](mailto:info@kuracorp.com)  
Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### 5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, te ketij nen mund të shkurtohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqerise.

### 6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**KURA CORP**” sh.p.k. është 1.000 (Nje mijë) leke i perfaqesuar nga 1 kuotë.

Ortaku është zoterues i kuotës qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise .

Kuot është nominative dhe nuk mund të përfaqësohet nga letra me vlerë.

Kuotat përfaqëson të drejtën e një votë.

## 7. ORTAKET

Ortaku i ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë “**KURA CORP**” sh.p.k do te jetë **znj. Kristi Davidhi** mbajtese e leternjoftimit nr. J86118074T. Administratori emërohet me Vendim të Asamblese se Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me te drejte ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**KURA CORP**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakut të shoqërisë.

## THEMELUESI

Muhamedali Kura

